



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 220, datë 28.12.2017**

**PËR**  
**REVOKIMIN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË SI VLERËSUES**  
**DËMESH NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I   S E:**

Në bazë të nenit 226 e vijues, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti licencon vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Z. Rudi Monari është licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve materiale dhe shëndetësore sipas licencës nr. 107, datë 23.12.2014.

Në zbatim të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, formati i raportimit (Formulari A), është i detyrueshëm për t’u plotësuar dhe depozituar në Autoritet nga vlerësuesit e pavarur dhe AMF-ja ka kërkuar depozitimin e saj brenda datës 30 korrik 2017.

Sipas këtij formati, Autoriteti monitoron kërkesat e ligjit që lidhen me disponimin e policës së sigurimit të përgjegjësive profesionale të vlerësuesit të dëmeve, referuar nenit 229, të Ligjit 52/2014, si dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij brenda 6-muajve nga data e marrjes së licencës, referuar nenit 228, të këtij ligji.

Z. Rudi Monari nuk ka depozituar formularin e kërkuar.

Në këto kushte, Autoriteti ka dërguar shkresën nr. 3327 prot. datë 01.12.2017, ku njofton se ka filluar procesin e revokimit të licencës së ushtrimit të veprimtarisë si vlerësues i dëmeve në sigurime, duke kërkuar paraqitjen në Autoritet për t'u dëgjuar.

Z. Rudi Monari është paraqitur në Autoritet për t'u dëgjuar më datë 06.12.2017 dhe është mbajtur procesverbal. Revokimi i licencës u kërkuar për arsye shëndetësore.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

### **V E N D O S I:**

1. Bazuar në nenin 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i revokohet licenca nr. 107, datë 23.12.2014, z. Rudi Monari, për të ushtruar veprimtarinë si vlerësues dëmsh në sigurime.
2. Licenca nr. 107, datë 23.12.2014, duhet të depozitohet në Autoritet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.
3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**